

De Evenaar

Qendra për Psikiatri Transkulturore Noord-Nederland

Informata për klientët

De Evenaar

De Evenaar, Qendër për Psikiatri Transkulturore, u ofron përkujdesje psikike të huajve me probleme psikiatrike që gjithashtu ballafaqohen edhe me probleme apo trauma transkulturore. De Evenaar ka selinë në Beilen dhe u ofron ndihmë të huajve të të gjitha moshave në Holandën Veriore. Në këtë broshurë mund të lexoni më tepër rreth mjekimit në Evenaar.

Për kë është destinuar de Evenaar?

De Evenaar u ofron përkujdesje psikiatrik të huajve. Në mjekimin që ofron Evenaar u përshtaten njerëzve me prejardhje nga një kulturë tjetër trajta të përgjithshme mjekimi psikiatrik.

Kujdesi që ofrohet nga psikiatria e përgjithshme nuk përputhet çdoherë me nevojën për kujdes që kanë të huajt. Arsye për këtë mund të jenë aspektet kulturore. Distanca që ndonjëherë krijohet nga dallimi i prejardhjes kulturore, mund të tejkalohet. Megjithatë kjo kërkon kohë, vëmendje dhe njohuri plotësuese të punonjësve socialë.

Përveç kësaj, de Evenaar ka njohuri dhe përvojë të posaçme në trajtimin e njerëzve që kanë përjetuar shumë ngjarje tronditëse. Njerëzit që mund të përfitojnë nga një trajtim në Evenaar shpeshherë vuajnë nga frika, zymtësia, pagjumësia, shqetësimi, makthet dhe dhembjet fizike. Këto shqetësime sjellin deri te kufizimi i jetës normale. Shumë njerëzve u duket sikur nuk e kanë më jetën në dorë, sikur e kanë humbur kontrollin.

Si duket trajtimi?

Mjeku juaj shtëpiak apo një punonjës social i GGZ Drenthe mund t'ju udhëzojë te Evenaar. Pastaj merrni një ftesë me shkrim për një bisedë të ashtuquajtur njoftuese. Ajo bisedë bëhet me një psikiatër apo psikolog dhe eventualisht me një terapist. Neve na duket e rëndësishme që edhe anëtarë të familjes ose persona të tjerë të besueshëm të marrin pjesë në atë bisedë. Nëse është e nevojshme, do të ftohet një përkthyes. Biseda njoftuese ka sidomos për qëllim që të njoftohemi dhe që të na tregoni se çfarë probleme dhe shqetësime keni. Në sajë të asaj bisede do të shihet se a është për ju i përshtatshëm një trajtim në Evenaar.

Për çdo klient hartohet një plan trajtimi. Në të shkruan se kush është trajtuesi juaj kryesor, cili është qëllimi i trajtimit tuaj dhe cilat terapi do t'i vijoni.

Ekzistojnë metoda të ndryshme trajtimi në Evenaar.

Trajtimi poliklinik

Trajtimi poliklinik paraqet trajtim vetjak, ku ju rregullisht bisedoni me një psikiatër, psikolog apo infermier(e) socio-psikiatrik(e). Përveç kësaj mund t'ju jepen ilaçe. Ekziston mundësi e posaçme për trajtim poliklinik të fëmijëve dhe të rinjve. Kur bëhet fjalë për probleme psikike të një apo më shumë anëtarë të një familjeje mund të bashkëpunohet me klinikën familjare të GGZ Drenthe.

Ndonjëherë nuk mjaftojnë bisedat dhe ilaçet për t'i zvogëluar ankimet tuaja. Në këshillim me ju atëherë mund të fillohet me një terapi plotësuese. Shpesh bëhet fjalë për terapi jo-verbale apo veprimtari ku vend qendror nuk zë të folurit, por të vepruarit.

De Evenaar, Centrum voor Transculturele Psychiatrie

Terapitë ndonjëherë jepen në mënyrë vetjake e ndonjëherë në grup. Shembuj terapish janë terapia psiko-motorike (lëvizja), terapia krijuese (si p.sh. piktura apo drama) ose terapia sistimore (së bashku me anëtarë të familjes).

Trajtimi ditor

Trajta më intensive e trajtimit ditor është pjesëmarrja në grupin dyditësh. Fillohet me një fazë orientuese që zgjatë tetë gjer dhjetë javë. Pastaj vijon faza trajtuese në një grup meshkujsh apo femrash. Programi përbëhet nga terapi të ndryshme, biseda vetjake dhe grupi dhe zgjatë më së gjati një vit. Përveç grupit dyditësh ekzistojnë edhe grupe të ndryshëm që ofrohen në kuadër të vazhdimit të kujdesit.

Shërbimi i veprimtarive

GGZ Drenthe ka disa mundësi për kalimin e ditës që klientët e de Evenaar mund t'i shfrytëzojnë. Kështu për shembull në Beilen ekziston një serrë për bimë, një punëtori për biçikleta si edhe një qendër e përgjithshme për veprimtari me, në mes të tjerave, një repart për tekstil dhe një për përpunimin e drurit.

Për më shumë njoftime

Në rast se edhe pas leximit të kësaj broshure keni ndonjë pyetje, mund të kontaktoni me repartin de Evenaar, numri i telefonit (059) 53 58 42.

De Evenaar, Centrum voor Transculturele Psychiatrie

GGZ Drenthe

De Evenaar
Qendër për Psikiatri Transkulturore
Altingerweg 1
9411 RA Beilen
Postbus 30000
9410 RA Beilen
Telefoni (0593) 53 58 42
Faksi (0593) 53 58 51
E-maili: deevenaar@ggzdrenthe.nl

De Evenaar është i vendosur në ndërtesën Weijerd. Klientët që vijnë për herë të parë mund të lajmërohen në sekretari, nëpërmjet hyrjes kryesore të ndërtesës Etstoel që ndodhet përkrah.

www.ggzdrenthe.nl

Çka është GGZ Drenthe?

GGZ Drenthe ofron kujdes psikik ambulant, poliklinik dhe klinik. Kujdesi shëndetësor mendor ofrohet në tri dega rajonale: Noord-Drenthe, Zuidoost-Drenthe dhe Zuidwest-Drenthe. Përveç kësaj GGZ Drenthe ofron psikiatri mjekoligjore klinike dhe ambulante.

Përkujdesja dhe kujdesi për pleq ofrohen në njërin nga dy shtëpitë për përkujdesje dhe dy shtëpitë për pleq.

Parandalimi, ndihma sociale dhe hulumtimi shkencor përbëjnë detyrat thelbësore të GGZ Drenthe. GGZ Drenthe ofron shumë mundësi arsimore, si p.sh. për psikiatër, psikolog në kujdesin shëndetësor, psikolog klinik, infermiere dhe motër medicinale.

Në GGZ Drenthe punojnë rreth 3.000 veta, të ndarë në dhjetëra seli në Drenthe. Në vit na drejtohen mbi 15.000 veta për t'i kërkuar shërbimet tona.

© 2006 GGZ Drenthe, Assen, NL.

ZW.023P (11/06)

Të drejtat e autorit për tërë materialin tekstual dhe figurativ i takojnë GGZ Drenthe dhe janë të mbrojtura me ligj. Huazimi i plotë apo i pjesshëm, në çfarëdo trajte qoftë, lejohet vetëm pasi paraprakisht të merret pëlqimi me shkrim nga ana e GGZ Drenthe. Kontaktoni me repartin për komunikim (Communicatie).